



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 24

Prishtinë, më 26 shtator 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Behar Selimi, Arsim Bajrami, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Amir Ahmeti dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Ardian Gjini dhe Mufera Şinik.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Fjolla Uka – NDI, Sanije Berisha – OSBE, Lynn Sheelon – ICO, Jonifer Ober – USAID, Artan Canhasi – EULEX, Albert Avdiu – KGJK, Merita Stublla Emini – USAID, Natyra Kasumaj – KDI, Shqipe Osmani – Bota Sot, Mendohije Krelani – Lajm, Sylë Ahmeti – Kosova Sot dhe Fixhrije Dragaj – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.08.2011,
3. Diskutim rreth përbërjes së Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës nr. 04/L-70,
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-64 për Agjencinë Kosovare të Forenzikës,
6. Shqyrtimi i çështjes për monitorim të ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar,
7. Të ndryshme.

***Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që në të ndryshme të shqyrtohen:

- Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-21 për Akcizën në Produktet e Duhanit,
- Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit nr. 04/665/L-41/1

Rendi ditës u miratua me ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.08. 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 22. 08. 2011, pa vërejtje.

3. Diskutim rreth përbërjes së Këshillit Gjyqësor të Kosovës

U diskutua për përbërjen aktuale të Këshillit Gjyqësor, çështja e konfliktit të interesit dhe anëtarëve që vijnë nga radhët e komuniteteve, lidhur me këtë debatuan: Arben Gashi, Arsim Bajrami, Haki Demolli, Merita Stublla – USAID, Armend Zemaj dhe Albert Avdiu – KGJK.

Lidhur me këtë pikë Komisioni njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- I. Të sqarohet çështja e Konfliktit të interesit nga KGJK- ja për tre anëtarët që është theksuar se janë në konflikt interesi,*
- II. Komunitetet t'i propozojnë anëtarët për KGJK dhe*
- III. Këshilli Gjyqësor i Kosovës të funksionojë sipas përbërjes aktuale.*

4. Shqyrtimi i Projektligjit për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës nr. 04/L-70

Kryetari, propozoi që kjo pikë të diskutohet në mbledhjen e radhës, sepse kemi kohë që ta shqyrtojmë këtë Projektligj.

Komisioni u pajtua që kjo pikë të hiqet nga rendi ditës.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-64 për Agjencinë Kosovare të Forenzikës

Kryetari - E paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Agjencinë Kosovare të Forenzikës dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse ka vërejtje për amendamentet.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-64 për Agjencinë Kosovare të Forenzikës, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
- 6. Shqyrtimi i çështjes për monitorim të ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar**

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion lidhur me këtë pikë njëzëri nxori këtë

Përfundim

Formohet grupi punues për monitorimin e ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar në këtë përbërje:

Behar Selimi, kryesues
Haki Demolli, anëtar dhe
Armend Zemaj, anëtar.

7. Të ndryshme

a. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-21 për Akcizën në Produktet e Duhanit

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për Akcizën në Produktet e Duhanit dhe nuk u paraqiten vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-21 për Akcizën në Produktet e Duhanit, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

b. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit nr. 04/665/L-41/1

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit. U paraqiten vërejtje në amendamentin 1 për të cilin dha sqarime Arben Gashi.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit nr. 04/665/L-41/1, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit Funksional e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk janë në mospajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë.
3. Komisioni për Legjislacion paraqet vërejtje në amendamentin 1 dhe i sugjeron Komisionit Funksional që amendamenti 1, neni 3 të përkufizimet fjala “ Virxhinja “ të hiqet. Sepse përkufizimi i tillë e kufizon mundësin që në furra të bëhet terja e llojit tjetër të duhanit përveç atij Virxhinja.

Mbledhja përfundoi në orën 13:05

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi